



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

**GJIMNAZI
SHKENCA SHOQËRORE**



Prishtinë, gusht 2008

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t' u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t' i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t' u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t' ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e sakta.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë, shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t' u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Tregtar flamujsh**I**

-Posi... U ba Shqipnija. Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija! Ti i meçëm, përgjegje tue bërtitë në kupë të qiellës: Rrnoftë, po! e shpejt me porositë flamujt. Na shkyeju: rrnoftë! e ti shit, ban pare tue tregtue mbi ndiesit t'ona. Lojë e bukur, por s'të ka dalë...

II

Gaspër Tragaci lëshoi shtizën e u avit kërcnueshëm kah djali. Flamuri ra për tokë. Hilushi s'luejti vendit. Shikonte syt e ftohtë qi lëshojshin shkëndija idhnimi. Tregtari u ndal para tij.

-Mos me kenë hatri i mikses së moçme qi kam me shtëpen t'ande, dij un...

I riu i a priti:

Për hatër t'asaj miksije tash qes bejta me t'u shit flamujt.

Me za qi dridhej prej pezmit, tjetri i a këthei:

-Po, zati ti s'din veç me qitë bejta. Jeto me pralla, bieru mbas andrrave. Më vjen keq për gjind të tuej se tash i qet në rrugë të madhe, më shka shof un. Hajt, hajt qit bejta e dueje Shqipnin: bejta e Shqipnija kanë me të qitë në dritë...

III

U afrue edhe ma tepër e pëshpëriti si në një fishkullimë:

-U shitne a s'u shitne flamujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue: a more vesht? e tash jashtë...

-Kadalë... – i a priti djaloshi me t'eger e syt i vetuen: dal vetë, s'asht nevoja me më qitë jashtë. Por edhe një fjalë due me t'a thanë e të lutem vire në vesh si at këshill qi më dhae par në dugajë. Ti thue se jeton, por rrehesh. Ti je shlye prej numrit të të gjallve qyshse je ndry në kët dugajë mbushë me mall. Ky asht vorri yt. E sa për Shqipni, po të siguroj un se ka me qindrue.

Ernest Koliqi

1. E folmja e personazheve në këtë fragment tregon se ngjarja ndodh në :
 - A. Shqipërinë e Veriut
 - B. Shqipërinë e Mesme
 - C. Kosovën Qendrore
 - D. Kosovën Lindore
2. Fjalja „*Jeto me pralla!*” shpreh:
 - A. çudi
 - B. urdhër
 - C. gëzim
 - D. pikëllim
3. Për ta argumentuar situatën më realisht autori i këtij teksti mbështetet në:
 - A. gjuhën e narratorit
 - B. gjuhën e personazheve
 - C. tekstin e narratorit të jashtëm
 - D. dialogun ndërmjet personazheve

4. Zëri i narratorit flet në fjalinë:
- Po, zati ti s' din veç me qitë bejta
 - Ti thue se jeton po rrelesh
 - Me za qi dridhej prej pezmit, tjetri ia ktheu
 - Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija
5. Paragrafi i parë shquhet për:
- sarkazëm
 - ironi
 - simbolikë
 - retorikë
6. Informata themelore e fragmentit përmbledhet në fjalinë:
- Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija
 - Na shkyeju: rrnoftë! e ti shit, ban pare tue tregtue mbi ndiesit t'ona
 - Po, zati ti s' din veç me qitë bejta. Jeto me pralla, bieru mbas andrrave
 - Për hatër t'asaj miksije tash qes bejta me t'u shit flamujt
7. Personazhi i drejtohet tjetrit: „Lojë e bukur, por s'të ka dalë”, sepse:
- loja e tij nuk është parë
 - loja e tij nuk është vërejtur
 - përpykja ishte e pasuksesshme
 - përpykja e tij ishte e bukur
8. Lidhëza „qyshse” në fjalinë: „Ti je shlye prej numrit të të gjallve qyshse je ndry në këtë dugajë mbushë me mall” mund të zëvendësohet me lidhëzën:
- prej se
 - sepse
 - meqenëse
 - megjithëse
9. Fjalja: „Shikonte syt e ftohtë qi lëshojshin shkëndija idhnimi” në shqipen standarde bën:
- Shiqonte sytë e ftohtë që lëshonin shkëndija hidhërimi
 - Shikonte sytë e ftofët që lëshonin shkëndija hidhërimi
 - Shiqonte sytë e ftohtë që lëshojshin shkëndija hidhërimi
 - Shikonte sytë e ftohtë që lëshonin shkëndija hidhërimi
10. Fraza: „bieru mbas andrrave”, në paragrafin e dytë do të thotë:
- jeto me ëndrra
 - vdis me ëndrra
 - shko pas ëndrrave
 - shpjego ëndrrat
11. Në fjalinë: „Shikonte syt e ftohtë qi lëshojshin shkëndija idhnimi”, figura e paradoksit ndërtohet ndërmjet gjymtyrëve:
- sytë dhe idhnimi
 - ftohtë dhe shkëndija
 - shikonte dhe lëshojshin
 - idhnimi dhe ftohtë

12. Indiferenca ndaj atdheut dhe egoizmi shprehen në fjalinë:

- A. U shitne a s' u shitne flamujt, qëndroi a s' qëndroi Shqipnija , un kam mjaft, shyqyr, me jetue
- B. Ti i meçëm, përgjegje tue bërtitë në kupë të qiellës: Rrnoftë, po! e shpejt me porositë flamujt
- C. Mos me kenë hatri i miksis së moçme qi kam me shtëpin t' ande, dij une
- D. Gaspër Tragaci lëshoi shtizën e u avit kërcënueshëm kah djali

13. Folja „*tue bërtitë*” në paragrafin e parë është formë e:

- A. dëftores
- B. pjesores
- C. paskajores
- D. përcjellores

Lexo me kujdes poezinë e mëposhtme dhe përgjigju pyetjeve!

ME JETUE

Erdhe në jetë
Nuk ka më nevojë për kuje lutje
Kryesorja të jetosh
Këtë gur ta hedhësh më lart se Unë

Prandaj

Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: i pari
Ai që ka ekzistuar para teje jam unë
Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrema
Për ëndrrat e mia e qetësinë je Ti
Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë
të natës
në pikë të vapës
asgjë mos rrit, asgjë mos krijo me dhunë
rast i humbur nuk je edhe pse pylli
Dendësohet
Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar
Në botë
Dhe si të duash Ti Lumi
Kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë
Dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë
E saj e zezë
Bashkudhëtari im
Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë.

Ali Podrimja

14. Motivi i kësaj poezie është:

- A. erotik dhe meditativ
- B. meditativ dhe personal
- C. patriotik dhe filozofik
- D. social dhe përshkrues

15. Forma e poezisë së dhënë është:

- A. sonet
- B. akrostik
- C. varg i lirë
- D. varg i rimuar

16. Vargu: „*Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë*” mund të interpretohet si:

- A. besim në jetë
- B. motivim për jetën
- C. zhgënjim nga jeta
- D. lutje për jetën

17. Mospërfillja e këshillës nga vargu: „*Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: i pari*”,

çon në formimin e një personaliteti:

- A. narcisoid
- B. injorant
- C. të përgjegjshëm
- D. të papërgjegjshëm

18. Folja në mënyrën lidhore haset në vargun:

- A. Ai që ka ekzistuar para teje jam unë
- B. Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
- C. Jetën ta jetosh pa e vrarë
- D. Me pleh kurrë mos u pajto

19. Lidhëza „*edhe pse*” në vargjet: „*rast i humbur nuk je edhe pse pylli
Dendësohet*”

mund të zëvendësohet me lidhëzën:

- A. meqenëse
- B. megjithëse
- C. duke qenë se
- D. për shkak se

20. Gradacioni ngritës hetohet në vargjet:

- A. Asgjë mos rrit, asgjë mos krijo me dhunë
- B. Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
- C. Kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë / Dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë/ E saj e zezë
- D. Ai që ka jetuar par teje jam Unë/ Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama/ për ëndrrat e qetësinë je Ti

21. Theksi logjik në vargun „*këtë gur ta hedhësh më lart se Unë*” bie në fjalën apo togfjalëshin:

- A. këtë gur
- B. më lart
- C. ta hedhësh
- D. se Unë

22. Folja urdhërore „mos rrit” në mënyrën dëshirore, veta e tretë njëjës, diateza veprorë, bën:
- A. mos rritë
 - B. mos u rritsh
 - C. mos rritsh
 - D. mos u rritshin

Lexo me kujdes fragmentin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjeve!

Problematiciteti shqiptar

Problemi ose Problematiciteti shqiptar... - Kemi trashëguar, thonë, një të shkuar kaotike; po kalojmë, thonë, një të tanishme kaotike: e ardhmja paraqitet si një zero matematike: „*Shiko të shpëtosh kokën tënde!*” - Këtë këngë vajtuese të këndojnë sot Pleq e të Rinj, dogmatikë e liberalë. Të ditur, të paditur, të gjithë njerëzit këtu brenda, i ka zënë një dobësi mistike, një lodhje morale dhe materiale. Dhe, si një rrjedhje e natyrshme e gjithë kësaj gjendjeje, një egoizëm vetjak, materialist, i lidhur ngusht me indiferencën, mërinë, ligësinë, dinakërinë më të përçmuar tejprtej!. – Simptoma më tipike dhe me klasike të dekompozimit. Simptoma të dekadencës, që paraqitin popujt në mbrëmjen e historisë së tyre...
Ku gjendemi?

Branko Merxhani

23. Forma e shkrimit si në fragmentin e dhënë më lart është tipike për:
- A. kritikën
 - B. poezinë
 - C. prozën
 - D. esenë
24. Diskursi i këtij fragmenti është:
- A. eseistik - letrar
 - B. bisedor - politik
 - C. eseistik - politik
 - D. gazetaresk - artistik
25. Në tekstin e dhënë, cilat janë simptomat e „*dekadencës, që paraqitnin popujt në mbrëmjen e historisë së tyre...*”?
- A. e shkuara kaotike, e tanishmja kaotike, e ardhmja si zero matematike
 - B. pleq e të rinj, dogmatikë e liberalë, këndojnë të njëjtën këngë vajtuese
 - C. të gjithë njerëzit i ka zënë një dobësi mistike, lodhje morale e materiale
 - D. egoizmi vetjak, materializmi, indiferenca, mëria, ligësia, dinakëria
26. Titulli më i përshtatshëm për këtë tekst do të ishte:
- A. mbrëmja e historisë
 - B. kaosi shqiptar
 - C. dekadencia morale
 - D. politika shqiptare

27. Sinonimi i fjalës „*kaos*” në shqip është:

- A. pengesë
- B. rrëmuje
- C. stagnim
- D. ngecje

28. Fraza: „*Shiko të shpëtoç, kokën t'ënde!*” në kuptim jo të figurshëm bën:

- A. përpiqu të shpëtosh vetveten
- B. shiko të shpëtosh kokën
- C. shiko të shpëtosh vetveten
- D. përpiqu ta shpëtosh kokën

29. Periudha asindetike: „*Kemi trashëguar, thonë, një të shkuar kaotike; po kalojmë, thonë, një të tashme kaotike, e ardhmja na paraqitet si një zero matematike*” është në të vërtetë:

- A. periudhë e bashkërenditur këpujore
- B. periudhë e bashkërenditur filluese
- C. periudhë e nënrenditur shkakore
- D. periudhë e nënrenditur lejore

30. Pas Kongresit të Drejtshkrimit, gjuha jostandarde mund të përdoret në shkrimet:

- A. administrative
- B. fiksiionale
- C. shkencore
- D. jofiksiionale

ENGLISH LANGUAGE

31. Mary has been saving for years. Now she has got \$ 3,562 on her bank account. She has got _____.

- A. three thousand and five hundred and sixty-two dollars
- B. three thousand and five hundred sixty-two dollars
- C. three thousand, five hundred, sixty-two dollars
- D. three thousand, five hundred and sixty-two dollars

32. Samantha, John and Ricky are students. They have had six examinations so far. Below is the table with their examination scores taken from students' examination records.

Read the table carefully and choose the correct answer:

EXAMS	SAMANTHA	JOHN	RICKY
ENGLISH	10	9	6
LITERATURE	7	8	9
SPANISH	8	8	7
ARTS	9	10	6
MEDIA & COMMUNICATIONS	6	9	10
GENDER STUDIES	10	8	9
Average grade	8.33	8.66	7.83

- A. Ricky proved poorer in media & communications than John.
- B. Samantha has got a higher grade than John in arts.
- C. Samantha has got the highest grade of all in gender studies.
- D. John is the best student in media and communications.

33. Read this text and then choose a sentence to complete the paragraph:

I am crazy about football. I always watch the matches of my favourite team. Last time, my team won a very important match. That's why _____.

- A. I treated all my friends
- B. I was very unhappy
- C. I was very disappointed
- D. I wanted to change my team

34. Choose the correct answer to complete the sentence:

Come and sit under the shadow. It's _____ here.

- A. more cooler
- B. much cooler
- C. more cool
- D. the coolest

35. Choose a word to complete the following sentence:

It's my father's birthday tomorrow. I'm in a trouble. I don't know what to buy and I don't have much time. Can you, please, _____ me?

- A. help
- B. support
- C. endorse
- D. sponsor

36. Look at the following adjectives. One of them DOES NOT exist. Which one?

- A. ruthless
- B. senseless
- C. tasteless
- D. smokyless

37. Choose the correct sentence:

- A. She told to me be on time for the meeting.
- B. She told me on time to be for the meeting.
- C. She told me to be on time for the meeting.
- D. She told me for the meeting to be on time.

38. Look at the words in the box and choose which sentence below is correct:

number – the – increasing - of – cars - the – is – road – on

- A. Number of the cars on the road is increasing.
- B. The number of cars on the road is increasing.
- C. The cars number of on the road is increasing.
- D. The number of cars on the increasing road is.

39. In this group of words three words have similar meaning except one.

Choose one word that is NOT similar to other three.

- A. award
- B. prize
- C. gift
- D. race

40. In many shops there is a small room in which you can put the clothes on and see whether you like them before you buy them. Therefore, from the following expressions:

1. guest room
2. change room
3. fitting room
4. wardrobe

you should ask the shop assistant to show you the '**fitting room**' because _____.

- A. this is the room where you try the clothes.
- B. this is the room where you store the clothes.
- C. this is the room where you change the clothes.
- D. this is the room where you fit the clothes.

41. The word **blew** does **NOT** rhyme with only one of these words. Which one?

- A. through
- B. thorough
- C. horseshoe
- D. bird-flu

42. In the string of words: **worked smiled, read, walked, talked**, the word **read** is different because _____.

- A. it is a regular verb
- B. it is in the past simple
- C. it is an irregular verb
- D. it is in the present simple

43. Read the paragraph carefully:

About ten percent of the population is left-handed and it seems to run in families. **The cause, therefore, seems obvious: genetics.** However, identical twins, who have identical genetic blueprint, aren't necessarily both left-handed. This would appear to disprove the theory that being left-handed is inherited.

Look at the highlighted text and complete the following sentence:

The author _____.

- A. has no idea of the cause of left-handedness
- B. is sure the cause of left-handedness is genetic
- C. approves the theory of inherited left-handedness
- D. supposes the cause of left-handedness is genetic

44. Read the following sentences carefully:

1. She will be a girl of seventeen wearing a bright red dress and black stockings.
2. She must be at least thirty-five years old.
3. Jennifer Jones is an experienced actress.
4. In spite of this she often appears on the stage as a young girl.
5. Jennifer will take part in a new play soon.

The correct order of sentences to form a paragraph is _____.

- A. 3 1 5 2 4
- B. 3 1 2 5 4
- C. 3 2 4 5 1
- D. 3 4 5 2 3


45. Many people from all over the world in those days were heading west in order to reach the 'Promised Land.' The expression 'Promised Land' was a synonym of a country. This country was _____.

- A. America
- B. Canada
- C. Mexico
- D. Argentina

MATEMATIKË

46. Është dhënë figura. Cila nga shprehjet vijuese paraqet syprinën e pjesës së hijezuar të figurës?

- A. $af - \frac{1}{2}ac$
- B. $ab - \frac{1}{2}ac$
- C. $\frac{1}{2}(ab - af)$
- D. $\frac{1}{2}(ab + ac)$



47. Një trup është hedhur nga lartësia prej $230m$. Gjatë sekondës së parë ai zbret për $25m$, gjatë sekondës së dytë $35m$, gjatë sekondës së tretë $45m$ e kështu me radhë. Kur do të bjerë trupi në tokë?


- A. për më pak se 5 sek.
- B. ndërmjet sekondës 5 dhe 6
- C. ndërmjet sekondës 6 dhe 7
- D. pas sekondës së 7

48. Cila është pikë e përbashkët e funksioneve $y = x^2 - x$ dhe $y = x$?

- A. $(0, 1)$
- B. $(1, 0)$
- C. $(0, 0)$
- D. $(1, 1)$

49. Është dhënë katërkëndëshi ABCD. Cili ekuacion kuadratik përcakton vlerën e x -it sipas të dhënave në figurë?

- A. $x^2 + 20x = 0$
- B. $x^2 - 20x = 0$
- C. $x^2 - 20x + 25 = 0$
- D. $x^2 + 20x + 25 = 0$



50. Në qoftë se vlen: $a^2 - b^2 = 117$ dhe $a - b = 3$, atëherë sa është vlera e shprehjes $a + b$?

- A. 31
- B. 33
- C. 36
- D. 39

51. Sa është vlera e shprehjes numerike komplekse: $A = (\sqrt{1+i})^4$, ku $i^2 = -1$?

- A. $A = 1$
- B. $A = i$
- C. $A = 2i$
- D. $A = 1 + 2i$

52. Në një bufe ndodhen 60 mysafirë, prej të cilëve 39 pinë kafe, 28 pinë ujë, kurse 16 pinë edhe kafe edhe ujë. Sa prej tyre nuk pinë as kafe e as ujë ?

- A. 0
- B. 1
- C. 8
- D. 9


53. Në një kompani janë tri grupe punëtorësh që marrin të ardhura sipas kualifikimeve, siç është paraqitur në tabelë. Sa janë përafërsisht të ardhurat mesatare ?

- A. 260 €
- B. 243.28 €
- C. 244.29 €
- D. 263 €

Grupi	Numri i punëtorëve	Të ardhurat
I	20	220€
II	10	260 €
II	5	310€

54. Është dhënë katrori ABCD (shih figurën) i cili rrotullohet për 540° me qendrën e rrotullimit në pikën e prerjes së diagonaleve të tij. Cili përkëmbim i përgjigjet këtij rrotullimi ?

- A. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ B & C & D & A \end{pmatrix}$
- B. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ C & D & A & B \end{pmatrix}$
- C. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ D & A & B & C \end{pmatrix}$
- D. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ A & B & C & D \end{pmatrix}$



55. Cila shprehje numerike i përgjigjet fjalisë:

“Prodhimi i shumës së numrave 0.4 dhe 0.2 me diferencën e tyre i rritur për 0.64” ?

- A. 0.72
- B. 0.74
- C. 0.76
- D. 0.78

56. Me cilën shprehje është ekuivalente shprehja $(3^{-1} \cdot \sqrt{2})^{-2}$?


- A. $\frac{9}{2}$
- B. $\frac{9}{4}$
- C. $\frac{3}{2}$
- D. $\frac{3}{4}$

57. Në qoftë se $\log_2 x = 3$ dhe $\log_3 y = 2$, atëherë sa është vlera e $\frac{x}{y}$?

- A. $\frac{3}{2}$
- B. $\frac{9}{4}$
- C. $\frac{8}{9}$
- D. $\frac{64}{81}$

58. Në trekëndëshin kënddrejtë njëri kënd i ngushtë është $\alpha = 30^\circ$ dhe njëri katet është $b = 8 \text{ cm}$. Sa është kateti tjetër ?

- A. 4 cm
- B. 8 cm
- C. $\frac{4\sqrt{3}}{3} \text{ cm}$
- D. $\frac{8\sqrt{3}}{3} \text{ cm}$



59. Në një mbrëmje shoqërore marrin pjesë: 32 nxënës të drejtimit shoqëror, 24 të drejtimit natyror dhe 26 të drejtimit matematikor. Nga salla nxirret rastësisht një nxënës. Sa është probabiliteti $P(x)$ që nxënësi i nxjerrë të jetë i drejtimit natyror ?

- A. $0.1 < P(x) < 0.2$
- B. $0.2 < P(x) < 0.3$
- C. $0.3 < P(x) < 0.4$
- D. $0.4 < P(x) < 0.5$

60. Janë dhënë tre termat e parë të vargut gjeometrik: 3, x , 48. Sa është vlera e x ?

- A. 8
- B. 12
- C. 16
- D. 24

HISTORI

- 61.** Periudha historike nga shekulli V-X karakterizohet me rendin shoqëror:
- A. Skllavopronar
 - B. Feudal
 - C. Kapitalist
 - D. Socialist
- 62.** Shteti i Indisë u themelua në luginat e lumenjve:
- A. Ind dhe Tigër
 - B. Tigër dhe Euftrat
 - C. Ind dhe Gang
 - D. Tigër dhe Gang
- 63.** Beteja e parë e Kosovës e vitit 1389 u zhvillua në mes të:
- A. Koalicionit Ballkanik dhe Perandorisë Osmane
 - B. Koalicionit Evropian dhe Perandorisë Osmane
 - C. Perandorisë Bizantine dhe Perandorisë Osmane
 - D. Perandorisë Osmane dhe Mbretërisë Hungareze
- 64.** Çfarë ndryshimi solli në jetën politike të Anglisë “Karta e madhe e Lirive “ e vitit 1215?
- A. Fillimin e jetës parlamentare dhe kufizimin e pushtetit kishtar
 - B. Forcimin e pushtetit mbretëror dhe fillimin e jetës parlamentare
 - C. Forcimin e pushtetit kishtar dhe dobësimin e jetës parlamentare
 - D. Fillimin e jetës parlamentare dhe kufizimin e pushtetit mbretëror
- 65.** Sllavët e jugut arritën në Gadishullin Ilirik (tokat arbërore), duke shkaktuar dëme të mëdha për popullsinë autoktone dhe për Perandorinë Bizantine. Cilat ishin pasojat e kësaj dyndjeje?
- A. Plaçkitja e popullsisë vendëse dhe dobësimi i pushtetit bizantin
 - B. Plaçkitja e popullsisë vendëse dhe dobësimi i pushtetit romak
 - C. Forcimi i pushtetit osman dhe asimilimi i popullsisë vendëse
 - D. Forcimi i pushtetit bizantin dhe përhapja e ortodoksizmit
- 66.** Me cilat Fuqi të Mëdha evropiane kishte marrëdhënie diplomatike Pashallëku i Janinës?
- A. Francën, Anglinë dhe Italinë
 - B. Francën, Anglinë dhe Rusinë
 - C. Anglinë, Austro-Hungarinë dhe Rusinë
 - D. Rusin, Austro-Hungarinë dhe Francën
- 67.** Radhitni sipas rendit kronologjik, ngjarjet të cilat shënuan procesin e shthurjes së Perandorisë Osmane dhe copëtimin e trungut kombëtar shqiptar:
- A. Kongresi i Berlinit, Konferenca e Shën Stefanit dhe Luftërat Ballkanike
 - B. Luftërat Ballkanike, Kongresi i Berlinit dhe Konferenca e Shën Stefanit
 - C. Luftërat Ballkanike, Konferenca e Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit
 - D. Konferenca e Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit dhe Luftërat Ballkanike

68. Cilat ishin ngjashmëritë në jetën politike të Gjermanisë dhe të Italisë pas Kongresit të Vjenës ?


- A. Gjermania dhe Italia realizuan unitetin politik të vendeve të tyre
- B. Gjermania dhe Italia nuk ishin të pushtuara nga Perandoria Ruse dhe Austro-Hungareze
- C. Gjermania dhe Italia nuk arritën të realizojnë unitetin politik të vendeve të tyre
- D. Gjermania dhe Italia ishin të pushtuara nga Britania e Madhe dhe Perandoria Austro-Hungareze

69. Ideja Iluministe në raport me idenë Skolastike mesjetare paraqiste:

- A. avancim në të menduarit shoqëror, që përparimin e njeriut e shihte në arsimim dhe zhvillim të shkencës dhe të kulturës
- B. avancim në të menduarit shoqëror, që përparimin e njeriut e shihte në ndryshimet e dhunshme politike
- C. një hap mbrapa në të menduarit shoqëror, që përparimin e njeriut e shihte në forcimin e dogmave fetare
- D. një hap mbrapa në të menduarit shoqëror, që përparimin e njeriut e shihte në forcimin e pushtetit mbretëror

70. Hapësira e paraqitur në hartë me vija horizontale shënon zonën e okupuar të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore nga forcat:

- A. Bullgare
- B. Gjermane
- C. Italiane
- D. Serbe



71. Cilat nga katër Perandoritë u shkatërruan pas Luftës së Parë Botërore ?

- A. Gjermania, Rusia, Austro-Hungaria dhe Perandoria Osmane
- B. Gjermania, Rusia, Austro-Hungaria dhe Britania e Madhe
- C. Rusia, Britania e Madhe, Italia dhe Perandoria Osmane
- D. Rusia, Franca, Italia dhe Britania e Madhe

72. Për dallim nga Luftërat e mëparshme, gjatë Luftës së Dytë Botërore pati:


- A. më pak viktima dhe më pak dëme materiale
- B. më shumë viktima dhe më pak dëme materiale
- C. më pak viktima në mesin e popullsisë civile dhe më shumë dëme materiale
- D. më shumë viktima në mesin e popullsisë civile dhe dëme materiale të mëdha

73. Cili është roli i Konferencës për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian?

- A. Forcimi i marrëdhënieve ekonomike
- B. Ndërtimi i marrëdhënieve kulturore
- C. Forcimi i marrëdhënieve ndërshtetërore evropiane
- D. Ndarja ndërmjet shteteve të zhvilluara dhe të pazhvilluara evropiane

GJEOGRAFI

- 74.** Cili liqen natyral në trojet etnike ka fundin e tij nën nivelin e detit?
A. Liqeni i Ohrit
B. Liqeni i Shkodrës
C. Liqeni i Prespës
D. Liqeni i Lurës
- 75.** Janë dhënë pohimet:
I. Buna është lumë me prurjen më të madhe të ujit në trojet etnike
II. Buna është lumë me gjatësinë më të madhe në trojet etnike
III. Buna është lumë me shpejtësinë më të madhe të ujit në trojet etnike
Cili nga pohimet është e saktë?
A. Vetëm I
B. Vetëm II
C. Vetëm III
D. I,II dhe III
- 76.** Nëse ndodhemi në qytetin e Prizrenit, në cilën anë të horizontit gjendet Prishtina?
A. Juglindje
B. Jugperëndim
C. Verilindje
D. Veriperëndim
- 77.** Nëse numri i banorëve të një shteti është 2 250 000, ndërsa dendësia e popullsisë 250 banorë në 1 km². Sa është sipërfaqja e atij shteti?
A. 8600 km²
B. 8800 km²
C. 9000 km²
D. 9200 km²
- 78.** Në cilat male gjendet pika më e lartë Mt.Everest me 8882m?
A. Himalaje
B. Kaukaz
C. Ural
D. Ande
- 79.** Cili është kryeqyteti i shtetit të hijezuar në hartë?
A. Pekini
B. Bagdadi
C. Teherani
D. Riadi



- 80.** Cilat brigje të kontinenteve lagen nga Deti i Kuq?
A. Brigjet e Evropës dhe Afrikës
B. Brigjet e Afrikës dhe Azisë
C. Brigjet e Evropës dhe Azisë
D. Brigjet e Afrikës dhe Australisë

- 81.** Si quhen pronat e mëdha bujqësore në të cilat zakonisht kultivohet një kulturë?
A. Prerie
B. Stepe
C. Savane
D. Plantazhe
- 82.** Me rritjen e lartësisë mbidetare temperaturat e ajrit zbresin në çdo 100 metra për $0,56^{\circ}\text{C}$. Sa do të jetë temperatura në 1000 metra lartësi nëse në 0 metra lartësi temperatura është 20°C ?
A. $h=1000$ metra, $\text{temp}=12^{\circ}\text{C}$
B. $h=1000$ metra, $\text{temp}=14,4^{\circ}\text{C}$
C. $h=1000$ metra, $\text{temp}=15,4^{\circ}\text{C}$
D. $h=1000$ metra, $\text{temp}=19^{\circ}\text{C}$
- 83.** Drenica është zonë kodrinore në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës e cila gjendet në mes të:
A. Fushës së Dukagjinit në perëndim dhe Fushës së Kosovës në lindje
B. Fushës së Dukagjinit në lindje dhe Fushës së Kosovës në perëndim
C. Fushës së Dukagjinit në veri dhe Fushës së Kosovës në jug
D. Fushës së Dukagjinit në jug dhe Fushës së Kosovës në veri
- 84.** Ndërrimi i drejtimit të lëvizjes së erërave pasate veriore është pasojë e:
A. shpejtësisë së rrotullimit të Tokës rreth Diellit
B. shpejtësisë së njëjtë e të gjitha gjerësive gjeografike rreth boshtit të Tokës
C. shpejtësisë jo të njëjtë e të gjitha gjerësive gjeografike rreth boshtit të Tokës
D. shpejtësisë jo të njëjtë e lëvizjes së masave ujore
- 85.** Cili nga pohimet është i saktë ?
A. Regresioni është dukuri që karakterizohet me tërheqjen e ujit të detit nga pjesët e kontinenteve
B. Regresioni është dukuri që karakterizohet me përmbytjen e pjesëve të kontinenteve nga uji i detit
C. Regresioni është dukuri që karakterizohet me shembjen e pjesëve bregdetare
D. Regresioni është dukuri që karakterizohet me çarjen e tokave në brigjet detare

FILOZOFI

- 86.** Për t'i ikur gjendjes natyrore, ku mbretëron "lufta e të gjithëve kundër të gjithëve". Çfarë do të duhej të bëhej sipas Hobsit?
- A. Të krijohej shteti
 - B. Të shpallej Republika e pavarur
 - C. Të shpallej Deklarata e pavarësisë
 - D. Të shpallej gjendje lufte
- 87.** Cila nga këto njësi sintaksore paraqet gjykimin në logjikë?
- A. "Qoftë i nderuar Sokrati!"
 - B. "Platoni është mendjendritur"
 - C. "Të na jetojë Platoni!"
 - D. "A është Aristoteli babai i logjikës?"
- 88.** Hipotezë quajmë:
- A. supozimin absolutisht të sigurt, por që nuk ka gjasë të vërtetohet mbi ndonjë dukuri apo grup dukurish
 - B. pohimin dogmatik për ndonjë dukuri natyrore, por jo edhe për dukuri shpirtërore e psikike
 - C. supozimin fillestar dhe jo të sigurt, por që ka gjasë të vërtetohet, supozim ky në bazë të cilit mund të jepen shpjegimet e para lidhur me ndonjë dukuri apo grup dukurish
 - D. dogmën fillestare dhe të sigurt mbi të drejtat dhe liritë e njeriut si qenie racionale që ka një vullnet të lirë dhe një ndërgjegje, e cila supozohet të jetë diçka shpirtërore dhe e pavarur nga trupi
- 89.** Në metafizikën e Aristotelit "substanca e dytë" paraqet:
- A. përcaktimin e posaçëm të qenies
 - B. kalimin nga një gjendje në një gjendje tjetër
 - C. përsëritjen e amshuar të së njëjtës gjë
 - D. përcaktimin e përgjithshëm të qenies
- 90.** Çfarë do t'i kishin rekomanduar stoikët një ushtari që zihet peng nga armiku dhe nga i cili kërkohen informata për t'i tradhtuar miqtë dhe shokët e tij me shpërblimin e premtuar se atë do ta lëshojnë të lirë, e që përndryshe do ta dënojnë me vdekje?
- A. I rekomandojnë të qëndrojnë dhe të durojnë
 - B. I rekomandojnë të tregojnë të vërtetën sepse nuk duhet gënjyer
 - C. I rekomandojnë që t'ua japë informatat për të shpëtuar jetën e vet
 - D. I rekomandojnë për të bashkëpunuar me ta, por për t'ua treguar vetëm gjysmën e të vërtetës

PSIKOLOGJI

- 91.** Cili drejtim psikologjik thekson rolin e proceseve të pavetëdijshme në veprimtarinë e njeriut?
- A. Drejtimi Biheviorist
 - B. Drejtimi Psikoanalitik
 - C. Drejtimi Kognitiv
 - D. Drejtimi Strukturalist
- 92.** Çfarë kanë të përbashkët amnezia dhe paraamenzia?
- A. Janë procese normale të kujtesës
 - B. Janë funksione të të menduarit
 - C. Janë çrregullime të kujtesës
 - D. Janë forma të të mësuarit
- 93.** Çrregullimi mendor disociativ, që karakterizohet me dy apo më shumë personalitete të ndara brenda një individi është:
- A. çrregullimi fobik
 - B. çrregullimi bipolar
 - C. çrregullimi obsesivo-kompulsiv
 - D. çrregullimi i shumëfishtë i personalitetit
- 94.** Disponimet janë:
- A. Gjendje emocionale të cilat zgjasin relativisht shumë dhe janë intensive
 - B. Emocione të vullshme dhe intensive të cilat nuk zgjasin shumë
 - C. Gjendje emocionale të cilat zgjasin relativisht shumë por nuk janë intensive
 - D. Emocione të vullshme dhe intensive të cilat zgjasin relativisht shumë
- 95.** Në periudhën e fëmijërisë së hershme (mosha 2 deri në 7 vjet) fëmijët sipas Zhan Piazhësë ndodhen në fazën paraoperacionale të zhvillimit kognitiv:
- I. në këtë stad fëmija është egocentrik ,që do të thotë fëmija është i paaftë për të kuptuar gjërat nga pikëpamja e tjerëve
 - II. në këtë stad fëmija përvetëson konceptin e konservimit ,që do të thotë kupton se karakteristikat e objekteve mbeten të njëjta përdërisa nuk shtohet apo nuk hiqet gjë
 - III. në këtë stad fëmija ka aftësi për të përdorur koncepte abstrakte
- Cili nga pohimet është i saktë ?
- A. Vetëm I
 - B. Vetëm II
 - C. Vetëm III
 - D. I, II dhe III

SOCIOLOGJI

- 96.** Themelues i “teorisë së elitave” është:
- A. Ogyst Konti
 - B. Vilfredo Pareto
 - C. Emil Dyrkemi
 - D. Maks Veberi
- 97.** Çfarë kanë të përbashkët monarkia dhe diktatura?
- A. Janë faktorë të socializimit
 - B. Janë forma të asimilimit të popullatës
 - C. Janë përbërës të kulturës
 - D. Janë forma të qeverisjes
- 98.** Poligjinia është:
- A. Martesa e një individi me një partnerë
 - B. Martesa e një individi me më shumë partnerë
 - C. Martesa e një burri me dy apo më shumë gra
 - D. Martesa e një gruaje me dy apo më shumë burra
- 99.** Sipas Veberit stratifikimi shoqëror është tredimensional; ekonomik, politik dhe kulturor. Dimensionit Politik të stratifikimit i referohet si Parti dhe nënkupton:
- A. Dallimin e grupeve shoqërore sipas kriterit të pronës dhe pozitës në tregun e punës
 - B. Dallimin e grupeve shoqërore sipas kriterit të fuqisë apo pushtetit
 - C. Dallimin e grupeve shoqërore sipas prestigjit dhe fuqisë apo pushtetit
 - D. Dallimin e grupeve shoqërore sipas prestigjit dhe stilit të jetës
- 100.** Janë dhënë pohimet
- I. Etnocentrizmi është vlerësimi i kulturës përmes standardit kulturor që ka vetë individi
 - II. Etnocentrizmi ka të bëjë me normat që nuk guxojnë të shkelen
 - III. Etnocentrizmi thekson se gjitha kulturat janë të lidhura mes vete dhe janë të vlefshme
- Cili nga pohimet është i saktë ?
- A. Vetëm I
 - B. Vetëm II
 - C. Vetëm III
 - D. I, II dhe III